

KËRKESË
Nr.1755, datë 13.6.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIMIN ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “EDISON DARDHA”

ISHSH-ja, Dega Rajonale e qarkut Tiranë, meqënëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë në adresën ku kryen aktivitet dhe në adresën e pasqyruar në QKB) duke u konfirmuar nga shërbimi postar “objekt i panjohur”.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale e qarkut Tiranë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH-TR-2019-001987-5, datë 31.5.2019 për subjektin Edison Dardha (Bar Kafe Shisha Room), me nr. NIPT-i L91309026A, me adresë: Njësia Kamëz, Bulevardi Blu, Objekti 2 katësh nr. 2, rruga Kavajës, kati 1, Tiranë.

KRYEINSPEKTOR
Gjergji Koja

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-TR-2019-001997 - 5

Datë 31.5.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 241 datë 27.3.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe procesverbalin e inspektimit Nr. ISHSH-TR-2019-001997 - 2, datë 31.5.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin Edison Dardha , me NIPT L91309026A, Përfaqësues i autorizuar i subjektit

Adhurim Losha ID: I81021072E, prej datës 31.5.2019 deri më datën 31.5.2019.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datë 31.5.2019 dhe e njoftoi më datën 31.5.2019. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006, i ndryshuar, neni 15/1, pika “d/15/d”,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 9636, datë 6.11.2006, i ndryshuar, neni 20, pika “ë/i”, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:
Gjobë 300 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:
Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:
Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave.
Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Zhelmira Thomaj ID_0401030002



Daniela Spahiu ID_0401030004




Manjola Kola

ID_



Personi i autorizuar i subjektit



Adhurim Losha ID: I81021072E

Kundër Vendimit Përfundimtar të inspektimit, subjekti **Edison Dardha** ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar.

Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror” të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.